



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE**

Nr. 33/35 Prot.

Tiranë më, 07/03/2024

V E N D I M

Nr. 20 datë 07.03.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

| | |
|------------------------|------------------|
| Loreta Hanxhari | Kryesuese |
| Bora Vrenjo | Relatore |
| Henri Naqellari | Anëtar |

asistuar nga anëtarja e Sekretariatit Teknik Znj. Ersila Kalaja, në datën 22.02.2024, ora 10:30, në Sallën e Mbledhjeve, kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT: **Z. Kastriot Tajar Skënderaj** me funksion Drejtor në Drejtorinë Vendore të Policisë Berat

OBJEKTI: **Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 12/2018** “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, (këtu e në vijim Ligji nr. 12/2018, i ndryshuar).

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoji dhe vlerësoi shpjegimet dhe argumentimin ligjor të Relatorit të çështjes, Znj.Bora Vrenjo; shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar si edhe dëgjoji subjektin në seancën dëgjimore,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni përgjegjës për kryerjen e procesit të vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, bazuar në Ligjin nr.12/2018, *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, i ndryshuar.
2. Subjekti i vlerësimit kalimtar, Kastriot Tajar Skënderaj, ka dorëzuar *deklaratën e pasurisë, deklaratën e kontrollit të figurës dhe formularin e vlerësimit të aftësive profesionale*, për funksionin Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Berat, sipas përcaktimeve të neneve 32, pika 2, 36 pika 1, dhe 44 pika 1, të Ligjit Nr.12/2018, *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, i ndryshuar.
3. Bazuar në nenin 6 të Ligjit nr.12/2018 *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, i ndryshuar, Kastriot Skënderaj është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Berat.
4. Subjekti i vlerësimit, Kastriot Skënderaj, iu nënshtrua procedurës së shortimit, në shortin e zhvilluar në datën 05.04.2023, nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.07 datë 17.01.2023 *“Për Procedurat dhe Mënyrat e Hedhjes së Shortit për Trupat e Vlerësimit dhe Subjektet e Vlerësimit të Ligjit 12/2018, i ndryshuar”*. Sipas shortit të zhvilluar, Trupa e Vlerësimit përbëhet nga Znj. Loreta Hanxhari (Kryesuese); Znj.Bora Vrenjo (Relatore) dhe Z. Henri Naqellari (Anëtar).
5. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit, sipas nenit 27, pika 1 të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar dhe neneve 30 dhe 31, të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr. 197, datë. 28. 02. 2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, vendosi me Vendimin nr.1 datë 18.04.2023, fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Kastriot Skënderaj si dhe të caktojë Kryesues të Trupës Vlerësuese Znj. Loreta Hanxhari.
7. Relatori i çështjes, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar të datës 18.04.2023, njoftoi subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar duke i bërë të njohur përbërjen e Trupës së Vlerësimit dhe duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
8. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, “Deklaratën për Konfliktin e Interesit” me nr. *** prot. , datë 19.04.2023, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
9. Relatori i çështjes, në përmbushje të detyrave ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, dhe sipas:
 - nenit 7, pika 1, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, nenit 4, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 19.04.2023 , pranë ILDKPKI-së, formularin e deklarimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit .
 - nenit 7, pika 7, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 19.04.2023, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, formularin e aftësive profesionale për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
 - nenit 7, pika 4, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 19.04.2023, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, deklaratën e kontrollit të figurës për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
10. Bazuar në nenin 34, pika 3, nenin 42, pika 1 dhe nenin 46, pika 2, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar janë administruar raportet e hartuara nga institucionet ndihmëse: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (në vijim AMP) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (në vijim DPPSH). Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.
11. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.

12. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, Trupa e Vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.

13. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit nr.12/2018 (i ndryshuar) ka për objekt:

- a) *vlerësimin e pasurisë;*
- b) *kontrollin e figurës;*
- c) *vlerësimin e aftësive profesionale.*

14. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:

- a) Ligjin nr.12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
- b) Ligjin nr.128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.
- c) Ligjin nr.40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”.
- d) Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”.
- e) Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm, nr.7, datë 17.01.2023, “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”.
- f) Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe ILDKPKI nr. 15, datë 27.01.2023, “Për miratimin e formularëve të deklarimit të Pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar.
- g) Rregulloren nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat proceduralë të unifikuar”.

Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

- *Deklarata e Pasurisë,*
- *Deklarata për Kontrollin e Figurës*
- *Formulari i Vlerësimit Profesional*
- *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet,*
- *Tri raportet ndihmëse të hartuara nga institucionet shtetërore;*
- *Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.*
- *Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.*

- *Ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.*
15. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 12 dhe 14, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar, nenit 3, pika 11 dhe nenit 5, të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.
 16. Me subjektin e vlerësimit, është komunikuar me anë të postës elektronike duke i bërë pyetje dhe kërkuar sqarime, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave.
 17. Trupa e Vlerësimit, pasi dëgjoi relatimin e bërë nga relatorja e çështjes dhe studioi materialin e përgatitur për këtë qëllim, krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kanë nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatuan se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Kastriot Skënderaj, me Vendimin nr.3, datë 06.02.2024, vendosi :
 - a) Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Kastriot Skënderaj;
 - b) Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht dhe*
 - *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraparak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*
 - c) Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Trupa e Vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47, të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 5 ditësh për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.
 18. Subjekti i vlerësimit, pas njoftimit me e-mail datë 06.02.2024, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Trupa Vlerësuese, e ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve duke dhënë sqarime mbi disa gjetje të pasqyruara në relacion. Sqarimet e paraqitura së bashku me dokumentacionin shoqërues, pasi u administruan, u analizuan dhe në përfundim u konkludua se nuk përbëjnë fakte të reja, por mbeten në kuadrin e sqarimeve të dhëna paraprkisht edhe gjatë fazës së hetimit administrativ.

II. SEANCA DËGJIMORE

19. Subjekti i vlerësimit, Kastriot Skënderaj, u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me e-mail, në datën 20.02.2024, ku dhe u njoftua se seanca publike dëgjimore është përcaktuar për t’u mbajtur në datën 22.02.2024, ora 10:30, në adresën: Salla e Mbledhjeve Kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme.

20. Seanca dëgjimore me subjektin, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, në datën dhe adresën e përcaktuar.
21. Subjekti i vlerësimit, gjatë seancës dëgjimore mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e vlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i vlerësimit Kastriot Skënderaj kërkoi nga Trupa Vlerësuese konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

22. Subjekti i vlerësimit, Z. Kastriot Skënderaj, ka qenë bashkëpunues në procesin e vlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikmëri afatet e përcaktuara nga Trupa Vlerësuese, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. ARSYETIMI LIGJOR I TRUPËS SË VLERËSIMIT

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Në bazë të nenit 32, pika 1, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, punonjësi deklaroi çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar që nga data e fillimit të marrëdhënies së punës në institucionin përkatës, pavarësisht datës së emërimit në pozicionin dhe/ose gradën që mban, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë.
24. Trupa e Vlerësimit ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe fakt, për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për punonjësin dhe për personat e lidhur me të, të parashikuar në nenin 31, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
25. Deklarimi i pasurisë nga subjekti kryhet sipas parashikimeve të nenit 32 e 33, ndërsa procedura e vlerësimit të pasurisë nga Trupa e Vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar.
26. Sipas kreut III, neni 33/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ILDKPKI-ja bazuar në deklaratimet e pasurisë, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli dhe në përfundim përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.
27. Hetimi administrativ i Trupës Vlerësuese pasi administroi dhe u njoh me Raportin e ILDKPKI-së, konsistoi në:

-verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;

- në verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të deklaruara;
- në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

28. Trupa e Vlerësimit për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë, ka thelluar hetimin nëpërmjet:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së pasurisë së vlerësimit kalimtar;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhat përkatëse, në raport me të dhënat në deklaratën e vlerësimit kalimtar;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jo financiare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve – gjendje cash;
- d) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetë deklaruara nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar.

29. Trupa e Vlerësimit i ka vlerësuar këto deklarime së bashku me provat e tjera në tërësi dhe harmoni me të gjitha rrethanat e çështjes.

30. Subjekti i vlerësimit Z. Kastriot Skënderaj ka plotësuar dhe dorëzuar deklaratën e pasurisë dhe dokumentacion justifikues për të justifikuar vërtetësinë e deklarimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, në zbatim të nenit 32, pika 2, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

31. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33/1, pika 3 e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka konstatuar se:

- a) Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka burime të ligjshme financiare;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

DEKLARIMI I PASURIVE NGA SUBJEKTI I VLERËSIMIT

Pasuria 1

Garazh në pronësi, me sipërfaqe 18 m², me nr. Pasurie ***, ind. i hartës *** ZK *** vol.**, fq.**, me adresë: Tiranë, "Shqipëri". Përfitur me kontratë shitblerje nr. ***rep., nr. ***kol., datë 13.06.2015 me shoqërinë "The Best Construction" sh.p.k. Vlera: 3.000 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: Të ardhura krijuar nga shitja e apartamentit të mëparshëm, porositur me kontratë sipërmarrje, shitur me Akt-marrëveshje nr. ***rep., nr. ***kol./2, datë 20.7.2006, me vlerë 52.000 euro.

📌 Dokumentacioni bashkëlidhur:

- Certifikatë për vërtetim pronësie nr.****, lëshuar në datë 23.6.2015, për pasurinë e llojit garazh në emër të Kastriot Skenderaj, me sip. 18 m2, me nr. Pasurie***, vol.**, fq.**, ZK**, ndodhur në Tiranë. Bashkëlidhur kartela e pasurisë ku në seksionin C evidentohet data e regjistrimit 23.6.2015, shumae paguar nga Kastriot Skënderaj në vlerën 3.000 euro, dhe shënimi "1013/225, 13.6.2015".

📌 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

Nga korespondenca me institucionet ligjzbatuese, është administruar dokumentacioni përkatës. Në lidhje me ekzistencën e pasurisë së paluajtshme, nga hetimi administrativ ka rezultuar:

- ASHK Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1, me shkresën nr. *** prot., datë 23.6.2023, nuk e konfirmon këtë pasuri të paluajtshme në emër të Kastriot Skënderaj.
- ISP Bank, me shkresën nr. ***prot., datë 11.5.2023, konfirmon nga nxjerrjet e llogarisë se Marinela Skënderaj ka depozituar në llogari në datën 15.6.2015, Shumën 3.000 euro dhe e ka transferuar atë në të njëjtën datë, në favor të noterit A. Mançka me përshkrim "sipas kont. Nr. ***Kol/ Rep *** Kastriot Skënderaj".

Subjekti ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë shitblerje nr. **rep., nr. ***kol., datë 13.6.2015 me shitës shoqërinë "The Best Construction" sh.p.k. dhe blerës Kastriot Skenderaj, për shitjen e pasurisë së llojit garazh me nr. Pasurie ***, me sip. 18 m2, ndodhur në Tiranë, në vlerën 3.000 euro.
- Kërkesë për transfertë datë 15.6.2015, lëshuar nga Intesa San Paolo Bank, për transferimin e vlerës 3.000 euro nga Marinela Skënderaj në favor të A. Mançka me përshkrim "sipas kont. Nr. ** kol. rep. ** (Kastriot Skënderaj)" me burim "kursime".
- Subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me burimin e deklaruar për pasurinë e llojit garazh të blerë në vitin 2015, duke deklaruar se burim kanë qenë paratë e ruajtura nga shitja e apartamentit në vitin 2006 (për të cilin janë dhënë shpjegime dhe është kryer hetim administrativ më poshtë) , të cilat i ka pasur gjendje cash në shtëpi ndonëse nuk janë reflektuar në deklaratimet periodike vjetore ndër vite gjatë periudhës nga shitja e apartamentit në 2006 deri në blerjen e garazhit në 2015.

Bazuar në deklarinë e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korespondencën e administruar, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

Garazhi me sip. 18 m2 në Tiranë në zotërim 100% të subjektit është përfituar me kontratë shitblerje të v. 2015, me burim të ardhura nga shitja e apartamentit të mëparshëm (trajtuar më poshtë).

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.**

- ✓ *Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me burimin financiar të përdorur për blerjen e garazhit në v. 2015.*
- ✓ *Konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.*

Pasuria 2

Apartament në pronësi, me sipërfaqe 109 m², me nr. Pasurie****, ind. i hartës: K-**-A), ZK***, vol. 26, fq. 80, me adresë: Tiranë, "Shqipëri". Përfitur me kontratë shitje nr***rep., nr. ***kol., datë 05.05.2010 me shoqërinë "The Best Construction" sh.p.k. Vlera: 4.530.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: Të ardhura të krijuara nga shitja e apartamentit të mëparshëm, porositur me kontratë sipërmarrje, shitur me Akt-Marrëveshje nr. ***rep., nr. ***kol./2, datë 20.7.2006, me vlerë 52.000 euro.

Dokumentacioni bashkëlidhur:

- Certifikatë për vërtetim pronësie nr.***, leshuar në datë 24.5.2010, për pasurinë e llojit apartament në emër të Kastriot Skënderaj, me sip. 108.9 m², me nr. Pasurie****, vol.***, fq.**, ZK****, ndodhur në Tiranë. Bashkëlidhur kartela e pasurisë ku evidentohet data e regjistrimit 24.5.2010 dhe shuma e paguar nga Kastriot Skënderaj në vlerën 4.530.000 lekë, me shenimin "kontratë shitje *****".
- Kontratë sipërmarrje me vërtetim noterial nr. *** rep., datë 09. 10.2002, të noteres V. Sulkaj, me porositës Kastriot Skënderaj dhe sipërmarrës shoqërinë "Haëai-ALB" sh.p.k., për porositjen e një apartamenti me sip. 75 m², ndodhur në adresën Tiranë, me vlerë 21.000 USD, me pagesë të ndarë në 2 këste (18.000 USD me lidhjen e kontratës dhe 3.000 USD me marrjen e çelësave).
- Akt-marrëveshje nr. ***rep., nr. ***kol./2, datë 20.7.2006, me palë Kastriot e Marinela Skënderaj dhe S. Braho, për zëvendësimin e Kastriot Skënderaj me S. Braho, në kontratën nr. ***rep., date 09.10.2002, duke i kaluar të gjitha të drejtat mbi apartamentin e porositur me atë kontratë, S. Brahos, kundrejt pagimit të vlerës 52.000 euro (të ndarë në 2 këste, 20.000 euro me lidhjen e marrëveshjes, dhe 29.000 euro më datë 1.10.2006 me transfertë bankare) ndaj porositësit Kastriot Skënderaj.
- Mandat arkëtimi datë 20. 7.2006 i Raiffeisen Bank, për depozitimin e shumës 20.000 euro nga S. Braho, në llogarinë e Kastriot Skënderaj.
- Mandat urdhër pagese datë 26.9.2006 i Alpha Bank për transfertën e shumës 29.000 euro nga llogaria e E dhe S. Braho në llogarinë e Kastriot Skënderaj.
- Mandat urdhër pagese, datë 29.12.2006, i Alpha Bank, për transfertën e shumës 3.000 euro nga llogaria e E dhe S. Braho në llogarinë e Kastriot Skënderaj.

- Kontratë shitblerje e pasurisë se paluajtshme nr.*** rep., nr. ***kol., datë 27.6.2002, me palë shitëse prindërit e subjektit dhe palë blerëse L. Mertiri, për shitjen e pasurisë së llojit apartament me sip. 78.7 m2, me nr. Pasurie****, vol.**, fq. ***, ZK ***, ndodhur në Fier, në vlerën 1.700.000 lekë (bashkëlidhur kontratës, kartela e pasurisë).

🚩 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

- ASHK Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1, me shkresën nr. ***prot., datë 23.6.2023, konfirmon se Kastriot Skënderaj ka të regjistruar pasurinë me nr.*****, vol.**, fq.**, ZK***, me sip. 108.9 m2 (bashkëlidhur Kartela e Pasurisë së Paluajtshme dhe Kontratë Shitje nr. ***rep., nr. ***kol., datë 5.5.2010 me shitës shoqërinë "The Best Construction" sh. p.k. dhe blerës Kastriot Skenderaj.
- RFZ Bank, me shkresën nr. ***prot., datë 08. 05. 2023, konfirmon nga nxjerrjet e llogarisë se Kastriot Skënderaj ka përfituar në 20.07.2006 kreditimin e shumës 20.000 euro me përshkrim "S. Braho derdhje në llogari për blerje apartamenti 75m2,. Shuma është tërhequr nga llogaria në të njëjtën datë.
- OTP Bank, me shkresën nr. 19/12 prot., date 5.5.2023, konfirmon se shtetasi Kastriot Skënderaj ka pasur llogari bankare pranë Alpha Bank, për të cilën OTP Bank disponon informacion për periudhën 2. 3.2009 e në vijim pasi nga ndryshimi i sistemit informatik në Bankë, platformat e mëparshme janë të paaksesueshme.

Dokumentacioni i administruar:

- Kontratë shitje nr. ***rep., nr. ***kol., datë 05.05.2010, me shitës shoqërinë "The Best Construction" sh.p.k. dhe blerës Kastriot Skënderaj, për blerjen e pasurisë së llojit apartament me nr. pasurie **** me sip. 108.9 m2, ndodhur në Tiranë, në vlerën 4.530.000 lekë.
- Librezë kursimi në valutë, me nr. *****e Alpha Bank, në emër të Kastriot Skënderaj, ku rezulton në 26.09.2006 depozitimi i vlerës 29.000 euro, dhe në 29. 12.2006, i shumës 3.000 euro. Tërhequr në 16.01.2007, vlera 9.000 euro, në 29. 01.2007, vlera 10.000 euro, dhe në 09.03.2007, vlera 10.000 euro.
- Subjekti ka sqaruar se pagesa 4.530.000 lekë, për blerjen e apartamentit në Selitë, Tiranë, në v. 2010, është bërë në cash në zyrat e shoqërisë "The Best Construction" shpk.

🚩 Në lidhje me blerjen e apartamentit nga shoqëria Haëai ALB sh.p.k në v. 2002 dhe më pas shitur në vitin 2006, subjekti sqaron se: Më datë 09.10.2002, Ka lidhur kontratë sipërmarrje me shoqërinë Hawaii-ALB, për blerjen e një apartamenti në shumën 21.000 dollarë, shumë e cila do të paguhej në dy këstë, kësti i parë 18.000 dollarë me lidhjen e kësaj kontrate dhe kësti i dytë 3.000 dollarë, në momentin e marrjes në dorëzim të apartamentit të përfunduar. Duke qenë se shoqëria Hawaii ALB nuk e përfundoi plotësisht ndërtimin e apartamentit, subjekti sqaroi se ishte paguar vetëm kësti i parë 18.000 dollarë.

Burimi i të ardhurave për blerjen e këtij të fundit ka qenë nga shitja e apartamentit të prindërve në Fier, në shumën 1.700.000 lekë ose 12.600 dollarë, dhe 5.400 dollarë, të ardhura/kursime të tjera të prindërve. Apartamenti në Fier, është blerë në vitin 1994 nga ana e prindërve, në vlerën 1.800.000 lekë me burim nga të ardhurat nga shitja e banesës së tyre në qytetin e Roskovecit, në vitin 1992 ose 1993, përfituar nga privatizimi, dhe të ardhura të tjera që ata kanë pasur. Subjekti ka sqaruar se prindërit kanë banuar gjithmonë me të dhe se babai i tij ka ndërruar jetë në vitin 2003, para se të transferohej në Pogradec, ku ka jetuar me gruan dhe nënën. Më datë 20.07.2006, subjekti dhe bashkëshortja e tij, kanë lidhur një akt marrëveshje përpara noterit me shtetasin S. Braho, me objekt zëvendësimin e Kastriot Skënderaj me S. Braho, në kontratën, datë 09.10.2002, duke i kaluar të gjitha të drejtat mbi apartamentin e porositur me atë kontratë, S. Brahos, kundrejt pagimit të vlerës 52.000 euro.

Dokumentacioni bashkëlidhur:

- Kontratë sipërmarrje me vërtetim noterial, datë 09.10.2002, me porositës Kastriot Skënderaj dhe sipërmarrës shoqërinë "Hawai-ALB" sh.p.k., për porositjen e një apartamenti me sip. 75 m2, ndodhur në Tiranë, me vlerë 21.000 USD, me pagesë të ndarë në 2 këste (18.000 USD me lidhjen e kontratës dhe 3.000 USD me marrjen e çelësave).
- Akt-marrëveshje datë 20.7.2006, me palë Kastriot e Marinela Skënderaj dhe S. Braho, për zëvendësimin e Kastriot Skënderaj me S. Braho, në kontratën, datë 9. 10.2002, duke i kaluar të gjitha të drejtat mbi apartamentin e porositur me atë kontratë, S. Brahos, kundrejt pagimit të vlerës 52.000 euro (të ndarë në 2 këste, 20.000 euro me lidhjen e marrëveshjes, dhe 29.000 euro më datë 1.10.2006 me transfertë bankare), ndaj porositësit Kastriot Skenderaj.
- Mandat arkëtimi datë 20. 7.2006 i Raiffeisen Bank, për depozitimin e shumës 20.000 euro nga S. Braho, në llogarinë e Kastriot Skënderaj.
- Mandat urdhër pagese datë 26.9.2006 i Alpha Bank për transfertën e shumës 29.000 euro nga llogaria e E. dhe S. Braho në llogarinë e Kastriot Skënderaj.
- Mandat urdhër pagese, datë 29.12.2006, i Alpha Bank, për transfertën e shumës 3.000 euro nga llogaria e E. dhe S. Braho në llogarinë e Kastriot Skënderaj.
- Kontratë shitblerje e pasurisë se paluajtshme, datë 27.6.2002, me palë shitëse prinderit e subjektit për shitjen e pasurisë së llojit apartament me sip. 78.7 m2, , ndodhur në Fier, në vlerën 1.700.000 lekë (bashkëlidhur kontratës, kartela e pasurisë).

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur si dhe në korrespondencën e administruar, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

- Apartamenti me sip. 109 m2 në Selitë, Tiranë, në vlerën 4.530.000 lekë, është përfituar me kontratë blerje të v. 2010 (poseduar nga subjekti që prej shtatorit të vitit 2008), me burim

nga shitja e apartamentit të mëparshëm në v. 2006 , në vlerën 52.000 euro, për të cilin subjekti kishte lidhur kontratë sipërmarrje në v. 2002, me vlerë 21.000 USD.

➤ Të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në v. 2006, konfirmohen nga mandate bankare në vlerën e përgjithshme 52.000 euro.

1. Subjekti, është përgjigjur mbi pyetjen nëse janë paguar detyrimet përkatëse tatimore në lidhje me shumën prej 52.000 Euro, të përfituara nga shitja e apartamentit sipas Akt-Marrëveshjes, si më poshtë vijon:

"...Apartamentin siç e kam shpjeguar edhe më sipër, duke qenë se në kohën e shitjes nuk kishte Certifikatë pronësie, shitja është bërë me Akt-marrëveshje dhe në dijeninë time tatimi mbi shitjen paguhet kur objekti i shitjes është me certifikatë pronësie, ndaj të gjitha detyrimet i ka marrë përsipër blerësi S. Braho në momentin e lidhjes së Akt-marrëveshjes. Shuma prej 52.000 Euro, sipas Akt-marrëveshjes është paguar me tre këste, në kohë të ndryshme në Alpha Bank A.E. Tiranë, këto të vërtetuara me faturat e lëshuara nga kjo bankë.

Trupa konstaton: Shitja e apartamentit nëpërmjet Akt-Marrëveshjes së lidhur në vitin 2006 ndërmjet subjektit dhe Z. Saimir Braho, ka gjeneruar të ardhura për subjektin, për të cilat duhej të ishin paguar detyrimet përkatëse tatimore sipas legjislacionit në fuqi (Neni 7 i Ligjit Nr. 8438 datë 28.12.1998 "PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT" i ndryshuar), pavarësisht se apartamenti i shitur nuk ka qenë i hipotekuar.

Sa më sipër, në analizën financiare, është marrë për bazë vlera e mbetur duke zbritur detyrimin tatimor sipas legjislacionit të periudhës përkatëse.

- Subjekti ka deklaruar shpenzime mobilimi 800.000 lekë, për apartamentin e blerë nga shoqëria "The Best Construction" sh.p.k. dhe 600.000 lekë për rregullimin e apartamentit të shitur, të blerë nga shoqëria "HAWAI-ALB" sh.p.k., për të cilat nuk disponon dokumentacion mbi shpenzimet e kryera.
- Blerja e apartamentit nga shoqëria "HAWAI-ALB" sh.p.k. në vlerën 18.000 USD është bërë në v. 2002, me burim të ardhura nga shitja e apartamentit të prindërve të subjektit në Fier (konfirmuar) dhe pjesërisht me kursime të prindërve në shumën 5.400 USD, për të cilën mungon dokumentacioni justifikues ligjor, rrjedhimisht është i aplikueshem neni 32, pika I.L, e ligjit nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat", i ndryshuar.
- ✓ ***Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.***
- ✓ ***Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me burimin financiar të përdorur për blerjen e Apartamentit në v. 2010.***
- ✓ ***Konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.***

Pasuria Nr. 3

Apartament në bashkëpronësi, me sipërfaqe 57.5 m2, me nr. Pasurie*****, ind. i hartës: SR:**, ZK***, me adresë Bashkia Sarandë.VIera: 25.000 euro. Pjesa takuese: 50%.

Burimi i krijimit: Llogari rrjedhëse në Bankën Raiffeisen sha., në emër të Marinela Skënderaj, me gjendje në 27.6.2022 në shumën 25.000 euro, krijuar nga të ardhura nga:

1. Shitblerja e autoveturës me targë AA****, në bashkëpronësi me b/shorten, me kontratë shitje nr. 98 rep., nr. 50 kol., date 17.01.2022, në shumën 10.000 euro.
2. Shitblerja e autoveturës me targë AA****, në bashkëpronësi me b/shorten, me kontratë nr. 483 rep., nr. 294 kol., datë 18.04.2018, në shumën 6.000 euro.
3. Shitja e autoveturës me targë AA****, në pronësi të b/shortes, me kontratë nr. 1472 rep., nr. 498 kol., datë 21.06.2021, në shumën 4.000 euro.
4. Paga, në llogarinë individuale të Kastriot Skënderaj, në bankën Raiffeisen, në shumën 600.000 Lekë (konvertuar në 5000 Euro).

Dokumentacioni bashkëlidhur:

- Kartela e pasurisë së paluajtshme me kod unik*****, lëshuar në datë 17.8.2022, për pasurinë e llojit apartament në emër të Kastriot e Marinela Skënderaj, me sip. 57.5 m2, me nr. Pasurie*****, ZK *****, ndodhur në Sarandë, me vlerë fillestare 25.000 euro, regjistruar me aktin nr. *** rep., nr. **** kol., datë 29.7.2022.
- Kontratë shitje automjeti datë 1. 11.2015, me shitës S. Kanani, Person Fizik, dhe blerës Kastriot e Marinela Skënderaj, për automjetin Mercedes Benz C***DI, me nr. Shasie*****, blerë në vlerën 600.000 lekë (bashkëlidhur faturë tatimore shitje, në vlerën 600.000 lekë).
- Kontratë shitblerje automjeti nr. ***rep., nr. ***kol., datë 18.4.2018, me shitës Kastriot e Marinela Skënderaj dhe blerës S. e Th. Gjoka, për automjetin me targë AA***MS, me nr. Shasie*****, shitur në vlerën 6.000 euro.
- Kontratë shitje pasuri e luajtshme nr. ***rep., nr***kol., datë 18.4.2019, me shitës A. Karapici dhe blerës Kastriot e Marinela Skënderaj, për automjetin me targë AA***XN, me nr. shasie *****, blerë në vlerën 1.200.000 lekë (bashkëlidhur mandat datë 19.4.2019 i RFZ Bank, për transferimin e shumës 1.200.000 lekë, nga Marinela Skënderaj për A. Karapici).
- Kontratë shitje pasuri e luajtshme nr. ** rep., nr. **kol., datë 17.1.2022, me shitës Kastriot e Marinela Skënderaj dhe blerës shoqëria "ELTEX" për automjetin me targë AA***XN, me nr. shasie *****, shitur në vlerën 10.000 euro (bashkëlidhur mandat datë 17.1.2022 i RFZ Bank, për transferimin e shumës 10.000 euro nga ELTEX sh.p.k, për Marinela Skënderaj).

- Kontratë shitblerje automjeti nr. ***rep., nr.*** kol., datë 11.4.2019, me shitës T. Ziu dhe blerës Marinela Skënderaj, për automjetin me targë A****XP, me nr. shasio *****blerë në vlerën 290.000 lekë.
- Kontratë shitje pasuri e luajtshme nr. ***rep., nr. **** kol., datë 21.6.2021, me shitës Marinela Skënderaj dhe blerës E. Braho, për automjetin me targë AA***XP, me nr. shasio ***** , shitur në vlerën 4.000 euro.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

- ASHK DV Sarandë, me shkresën nr. *** prot., datë 27.7.2023, nuk konfirmon pasuri në emër të Kastriot Skënderaj dhe personave të lidhur me të.
- DPSHTRR, me shkresën nr. *** prot., datë 22.5.2023, konfirmon se Kastriot Skenderaj ka pasur të regjistruara mjetet me targa aktuale AA****, AB**** dhe se shtetasja Marinela Skënderaj ka pasur të regjistruara mjetet me targa aktuale AA****, AB**** dhe AA****. Nga dokumentacioni bashkëlidhur shkresës së DPSHIRR, rezulton se:
 - Shtetasit Marinela dhe Kastriot Skënderaj kanë pasur në bashkëpronësi automjetin me targë AA**** me nr. shasio ED****, blerë me faturë tatimore shitje nr.**, datë 01.11.2015 në vlerën 600.000 lekë dhe shitur me kontratë shitblerje automjeti nr. ** rep., nr. ** kol., datë 18.4.2018 në vlerën 6.000 euro.
 - Shtetasit Marinela dhe Kastriot Skënderaj kanë pasur në bashkëpronësi automjetin me targë AA****, me nr. shasio JG****, blerë me kontratë shitje pasuri e luajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.04.2019, në vlerën 1.200.000 lekë dhe shitur me kontratë shitje pasuri e luajtshme nr. **rep., nr. ** kol., datë 17.1.2022, në vlerën 10.000 euro.
 - Shtetasja Marinela Skënderaj ka pasur në pronësi automjetin me targë AA****, me nr. shasio VF****, blerë me kontratë shitblerje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.4.2019, në vlerën 290.000 lekë dhe shitur me kontratë shitje pasuri e luajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.06.2021 në vlerën 4.000 euro.
- RFZ Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 08. 05. 2023, konfirmon nga nxjerrjet e llogarisë në Euro se Marinela Skënderaj ka përfituar: Në datën 21.06.2021 kreditimin e shumës 3999 euro nga shtetasja Erinda Braho, sipas përshkrimit “Pagesë Kontratë Shitje pasuri e paluajtshme Nr.REP. ***, Nr. KOL***, DT. 21.06.2021; në datën 15.7.2021, kreditimin e shumës 6.000 euro me përshkrim "të ardhura nga shitje makine sipas kontrates nr.483 rep. nr. 294 kol. dt. 18.04.2018"; në datën 17.1.2022, kreditimin e shumës 10.000 euro me përshkrim "ELTEX shpk., likuidim total për blerje automjeti Mercedes, targa AA***XN"; në datën 27.06.2022, depozituar shuma 5.000 euro, me përshkrim "Marinela Skenderaj derdh kursime nga paga e bashkëshortit ". Gjithashtu konfirmon nga nxjerrjet e llogarisë së Marinela Skënderaj, transfertën në datën 29.7.2022, të shumës 25.000 euro, në favor të E. Kolagji PF, me përshkrim "kalim sipas kontratës nr. ***rep. nr. ***kol. dt. 29.07.2022".

Gjendja në llogarinë datën 03.03.2023, rezulton në vlerën 1 euro. Gjithashtu konfirmon nga nxjerrjet e llogarisë së Kastriot Skënderaj, se janë kryer terheqje përkatësisht në datat 22.06.2022, në vlerën 500.000 lekë, 25.06.2022, në vlerën 80.000 leke, dhe 25.06.2022, në vlerën 20.000 lekë (shuma 600.000 lekë). Gjithashtu konfirmon nga nxjerrjet e llogarisë së Kastriot Skënderaj, se në datën 28.3.2013 është disbursuar kredi në vlerën 600.000 lekë.

- Subjekti ka sqaruar se për apartamentin në Sarandë, ka shpenzuar rreth 1.000.000 lekë, nga të ardhurat e krijuara prej kursimeve nga paga e tij dhe e bashkëshortes.

Subjekti sqaroi në lidhje me burimin e blerjes së automjeteve të cituara më sipër:

- Automjeti Mercedes Benz C *** CDI, blerë në v. 2015 në vlerë 600.000 lekë, ka si burim të ardhurat nga shitja e automjetit të mësipërm në vlerën 400.000 lekë dhe 200.000 lekë, nga kredia në Raiffeisen Bank, datë 28.03.2013, në shumën 600.000 lekë, sipas kontratës bashkëlidhur.
- Automjeti Mercedes Benz, me targë AA550XN, blerë në v. 2019, në vlerën 1.200.000 lekë, ka si burim kursimet e pagës së bashkëshortes.
- Automjeti Peugeot targë AA***XP, blerë në v. 2019, në vlerën 290.000 lekë, ka si burim të ardhurat e krijuara nga paga e tij dhe e bashkëshortes.
- Në lidhje me shitjen në vlerë më të lartë të automjetit tip Peugeot me targë AA***XP në v. 2021, subjekti sqaroi se automjeti, kur është blerë në v. 2019, ka pasur një defekt në pjesët mekanike, të cilat janë riparuar me shpenzimet e tij dhe automjetit i janë bërë edhe shërbimet e nevojshme, që ka bërë që automjetit t'i rritej vlera rreth 1.000 euro, prandaj kur është shitur ka pasur vlerë më të lartë.
- Në lidhje me mobilimin e banesës në Sarandë, sqaroi se ka shpenzuar rreth 1.000.000 lekë, të cilat janë kryer menjëherë pas blerjes së shtëpisë pas datës 29.07.2022. Nuk përcakton dot vlera specifike për çdo send të blerë, pasi janë blerë sipas ofertave të momentit dhe se nuk disponon fatura për blerjet e kryera.
- Subjekti ka dorëzuar dokumentacionin shoqëruar si më poshtë:
 - Kontratë shitje pasuri e paluajtshme nr. ***rep., nr. ***kol., datë 29.7.2022, hartuar nga noter E. Kolagji me shitës A. Fejzo e G. Fejzo dhe blerës Kastriot e Marinela Skënderaj, me objekt shitblerjen e pasurisë së paluajtshme të llojit apartament, me nr.****, vol.***, fq.***, ZK ***, me sip.57.50 m2, ndodhur në Sarandë, në vlerën 25.000 euro, e cila do të shlyhet nëpërmjet sistemit bankar, në datën 29.07.2022.

- Kontratë kredie bankare datë 28.3.2013, lidhur midis Raiffeisen Bank sha. dhe Kastriot e Marinela Skënderaj, për marrjen e kredisë në vlerën 600.000 lekë, me qëllim përdorimin për arsye personale.
- Në lidhje me shitjen në v. 2018, të automjetit me targë A****MS, subjekti sqaroi se vlera e shitjes që rezultoi më e lartë nga ajo e blerjes në v. 2015, është një shumë e vogël dhe kjo vjen si rezultat i shumave të shpenzuara për këtë automjet me qëllim kryerjen e shërbimeve për riparimin e tij, duke e përmirësuar gjendjen e automjetit.
- Në lidhje me burimin e shumës 1.000.000 lekë, të përdorur për arredimin e banesës në Sarandë, subjekti sqaroi se shpenzimet janë kryer jo të gjitha menjëherë në shumën totale 1.000.000 lekë, por në vlera të ndara. Për ndonjë shumë të vogël ka përdorur për momentin edhe shuma monetare të dhëna nga familjarët e tij, konkretisht kunati (vëllai i bashkëshortes) A. Thano, të cilat i ka përdorur dhe i ka kthyer brenda vitit përsëri, nga të ardhurat vjetore familjare nga paga, prandaj edhe si burim ka konsideruar të ardhurat nga paga dhe kursimet familjare edhe në sqarimet e dhëna më parë.

Bazuar në deklarinë e subjektit, dokumentacionin e paraqitur si dhe në korrespondencën e administruar, në mënyrë të përmbledhur rezultoi se:

- ✓ *Apartamenti me sip. 57.5 m2 në Sarandë, me vlerë 25.000 Euro, në bashkëpronësi me b/shorten, është përfituar me kontratë blerje të v. 2022, me burim nga pakësimi i llogarisë së b/shortes në RFZ Bank, e cila ka patur si burim të ardhurat nga shitja e automjeteve gjatë periudhës 2018 - 2022 dhe kursimet familjare.*
- ✓ *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar. DPSHTRR, konfirmon blerjet/shitjet e automjeteve.*
- ✓ *Subjekti ka deklaruar shpenzime mobilimi të kryera në vitin 2022, për apartamentin në Sarandë, në shumën 1.000.000 lekë.*
- ✓ *Konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.*

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

Subjekti deklaron:

1. Të ardhura nga funksioni Punëtor Operativ për Krimet dhe Shef i Krimeve në DPB, Tepelenë, për periudhën 1.7.1989 - 31.1.1993. Shuma 31.575 Lekë.
2. Të ardhura nga funksioni Inspektor Krimesh dhe Shef i Policisë Kriminale, Komisariati i Policisë Fier, për periudhën 1.2.1993 - 22.3.1997. Shuma 179.000 Lekë.
3. Të ardhura nga funksioni Inspektor Krimesh në Komisaratin e Policisë Mallakastër, për periudhën 16.10.1997 - 15.3.1998. Shuma 33.240 lekë.

4. Të ardhura nga funksioni Inspektor Krimesh dhe Shef i Policisë Kriminale, Komisariati i Policisë Gjirokastrë, për periudhën 16.3.1998 - 20.10. 1998. Shuma 102.649 Lekë.
5. Të ardhura nga funksioni Inspektor i Policisë Kriminale, Qyteti Patos, Inspektor i Policisë Kriminale, Komisariati i Policisë Fier, Inspektor i Zyrës Rajonale L.K. Drogës Fier dhe Shef i Policisë Kriminale në Komisaratin e Policisë Lushnje, për periudhën 21.10.1999 - 15.10.2001. Shuma 802.193 Lekë.
6. Të ardhura nga funksioni Specialist Sektori Hetimeve të Posaçme në Drejtorinë Qendrore të Policisë Kriminale në DPPSH, për periudhën 16.10.2001 - 24.3.2004. Shuma 1.192.658 Lekë.
7. Të ardhura nga funksioni Shef Komisariati i Policisë Pogradec dhe Drejor i DVP, Korçë, për periudhën 25.3.2004 - 20.10.2005. Shuma 1.050.052 Lekë.
8. Të ardhura nga funksioni Specialist Drejtimi në Sektorin Kundër Krimeve ndaj Personit/Pronës, në Drejtorinë Kundër Krimeve të Rënda në DPPSH, për periudhën 21.10.2005 - 14.3.2012. Shuma 5.916.661 Lekë.
9. Të ardhura nga funksioni Shef Komisariati i Policisë Kufitare Sarandë DRKM Vlorë, për periudhën 15.3.2012 - 15.11.2012. Të ardhura nga funksioni Shef Sektori i Migracionit në DRKM Vlorë, për periudhën 16.11.2012 - 11.12.2012. Shuma 811.560 Lekë.
10. Të ardhura nga funksioni Specialist, Sektori i Shërbimeve të Kufirit të Gjellbër në Drejtorinë e Kufirit të Migracionit, Specialist i Hetimit në Drejtorinë Operacionale në Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit, për periudhën 12. 12.2012 - 8.10.2013. Shuma 644.734 Lekë.
11. Të ardhura nga funksioni Drejtor, Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, për periudhën 9.10.2013 - 4.9.2014. Shuma 936.360 Lekë.
12. Të ardhura nga funksioni Drejtor, Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë, për periudhën 5.9.2014 - 26.8.2015. Shuma 1.288.115 Lekë.
13. Të ardhura nga funksioni Drejor, Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Tiranë, për periudhën 27.8.2015 - 15.2.2018. Shuma 3.356.958 Lekë.
14. Të ardhura nga funksioni Drejtor, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, për periudhën 16.2.2018 - 11.3.2019. Shuma 1.448.920 Lekë.
15. Të ardhura si Këshilltar dhe Drejtor i Kabinetit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për periudhën 12.3.2019 - 22. 11.2022. Shuma 5.333.815 Lekë.
16. Të ardhura nga funksioni Drejtor, Drejtoria Vendore e Policisë Berat, për periudhën 23.11.2022 - aktualisht. Shuma 342.299 Lekë.

Dokumentacioni bashkëlidhur:

- Vërtetim i Raiffeisen Bank datë 15.2.2023, me të dhënat vjetore mbi produktet bankare të klientit Kastriot Skënderaj, ku evidentohet llogari rrjedhëse në lekë me kreditime totale vjetore për periudhën 2005 - 2022 dhe llogari rrjedhëse në euro, me kreditime totale vjetore për periudhën 2006 - 2008.
- Vërtetim nr. ***prot., datë 23.6.2022, i Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastrë për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të Kastriot Skënderaj, për pagat neto të përfituara në v. 1989 = 3.900 lekë, v. 1990 = 7.800 lekë, v. 1991 = 8.175 lekë, v. 1992 = 10.800 lekë, v. 1993 = 900 lekë, v. 1998 = 102.649 lekë. Shuma e përgjithshme = 134.224 lekë.
- Vërtetim me vulë digitale, datë 27.6.2022, i Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, për bazën e vlerësueshme të Kastriot Skënderaj, për pagat neto të përfituara në v. 1993 = 33.550 lekë, v. 1994 = 45.951 lekë, v. 1995 = 47.724 lekë, v. 1996 = 39.770 lekë, v. 1997 = 11.931 lekë, v. 1998 = 35.112 lekë, v. 1999 = 302.960 lekë, v. 2000 = 267.247 lekë, v. 2001 = 218.783 lekë. Shuma e përgjithshme = 1.003.028 lekë.
- Vërtetim nr. ***prot., datë 27.6.2022, i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për të ardhurat neto nga paga të Kastriot Skënderaj, për periudhën 16.10.2001 - 25.3.2004, në shumën 1.192.658 lekë.
- Vërtetim nr. ***prot., datë 17.4.2018, i Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë për të ardhurat neto nga paga të Kastriot Skënderaj, për periudhën 25.3.2004 - 10.9.2004, në shumën 262.551 lekë, dhe për periudhën 11.9.2004 - 20.10.2005, në shumën 787.501 lekë. Shuma e përgjithshme = 1.050.052 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

- Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 8.5.2023, konfirmon nga nxjerrjet e llogarisë, se Kastriot Skënderaj ka përfituar të ardhura nga paga, shpërblime, veshje, dieta, honorare, për periudhën maj 2005 - mars 2023, në shumën totale rreth 19.913.000 lekë. (në llogaritjen totale më poshtë zbritur nga kjo shumë 422.807 lekë të përfshira edhe në vërtetimin më sipër për vitin 2005). Gjendja e llogarisë nr. *****në datën 03.03.2023, rezulton në vlerën 858.480 lekë.
- Tirana Bank, me shkresën nr. ***prot., datë 12.5.2023, konfirmon nga nxjerrjet e llogarisë, së Kastriot Skënderaj ka përfituar të ardhura nga paga në vitin 2011, në shumën = 151.151 lekë.
- ISSH, me shkresën nr. ***prot., datë 10.5.2023, konfirmon se Kastriot Skwnderaj ka realizuar tw ardhura nga punwsimi për periudhën mars 2012 - prill 2023, nga organet në varësi të Policisë së Shtetit.

- *Në lidhje me mosevidentimin e gjendjes së likuiditeteve në llogari bankare, subjekti sqaroi se është keqkuptuar në mënyrën e deklarimit të formularit. Gjithashtu sqaroi se bashkëlidhur formularit ka depozituar dokumentacion në lidhje me llogaritë bankare, ku identifikohen këto llogari në zotërimin e tij dhe të bashkëshortes, e për rrjedhojë e ka konsideruar të ezauruar detyrimin e tij, për të identifikuar llogaritë bankare, duke qenë se ka paraqitur edhe dokumente në lidhje me këto llogari, pa patur qëllim mospasqyrimin.*

Konstatohet:

- ✓ *Të ardhurat e subjektit nga paga, shpërblimet, dietat, honoraret, etj., për periudhën korrik 1989 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 23.125.672 lekë.*
- *Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me mospasqyrimin e gjendjes së mbetur në llogarinë e pagës, për te cilën b/lidhur deklaratës së pasurisë ka paraqitur vërtetim bankar për numrin e llogarisë. RFZ Bank konfirmon gjendjen në dt. 03.03.2023, në shumën 858.480 lekë.*

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

- ✚ Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të githa ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur - Periudha 1.1.2022 - 31.12.2022.

Subjekti deklaron:

Shpenzimet e vitit të fundit janar - dhjetor 2022 sipas librezave përkatëse:

- Për ujë në vlerën 17.980 lekë.
- Energji elektrike në vlerën 74.500 lekë.
- Telefon dhe internet në vlerën 27.000 lekë.
- Shërbim celular në vlerën 15.600 lekë.

Shuma totale 136.000 lekë.

✚ **Dokumentacioni bashkëlidhur:**

- Librezë e Ujësjellës Kanalizime Tiranë, me nr. Kontrate****, në emër të Kastriot Skënderaj, për pagesën e detyrimit mujor në shumën e përgjithshme 17.980 lekë, për vitin 2022.
- Librezë e OSHEE me nr. Kontrate ****, qendra Tiranë, në emër të Kastriot Skënderaj, për pagesën e detyrimit mujor në shumën e përgjithshme 74.486 lekë, për vitin 2022.

- Librezë telefoni e Albtelecom, për nr. e telefonit *****, në emër të Kastriot Skënderaj, për pagesën e detyrimit mujor në shumën e përgjithshme 27.000 lekë, për vitin 2022.

🚩 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

- FSHU, konfirmon se Kastriot Skënderaj rezulton të ketë lidhur një kontratë për shërbimin e furnizimit me energji elektrike në instancën Sarandë.
- Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Tiranë, me shkresën nr. *** Prot., datë 02.05.2023, konfirmon se Kastriot Tajar Skënderaj, rezulton të ketë lidhur kontratë për objektin me adresë "Liqeni i Thatë", me status aktiv.
- 14 Shoqëritë Rajonale të Ujësjellës - Kanalizime, me shkresat nr. **** prot., nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- Vodafone Albania sh.a., konfirmon se Marinela Skënderaj ka në emrin e saj 2 numra të telefonisë celulare, për të cilat ka shpenzuar gjatë vitit 2022, shumën 20.598 lekë.
- One Albania sh.a, me shkresën nr.****, dt. 19.6.2023, konfirmon se Kastriot Skënderaj ka në emrin e tij 1 numër të telefonisë fikse, për të cilin ka shpenzuar gjatë vitit 2022, shumën 27.000 lekë.

Konkluzione:

- ✓ *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e FSHU, UKT, Vodafone Albania dhe One Albania.*
- ✓ *Shpenzimet për ujë + drita + telefoni + internet, gjatë periudhës së sipërcituar, me kontrata në emër të subjektit dhe/apo personave të lidhur me të, rezultojnë në total rreth 152.000 lek.*
- 🚩 Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara- Periudha 1.1.2020 - 31. 12.2022.

Subjekti deklaron:

- Udhëtime në Greqi, për pushime familjarisht, në vitin 2021 dhe 2022, të përfshira udhëtimi dhe qëndrimi, pa agjenci. Shuma 3.000 euro.
- Udhëtim në SHBA (vizitë pune), datë 31.05.2022 - 06.06.2022, të përfshira të gjitha shpenzimet dhe të paguara nga Ambasada e SHBA, Tiranë. Shuma 2.000 euro.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

- Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ***prot., datë 8.5.2023, konfirmon nga nxjerrjet e llogarisë së Kastriot Skënderaj ka përfituar kreditimin e shumës = 182.606 lekë, me përshkrim "Payment Skënderaj INL. Travel in Washington".
- Subjekti sqaroi se ka udhëtuar ne Greqi me pushime familjarisht, për dy vitet 2021 dhe 2022, dhe ka kryer shpenzime nga të ardhurat e përfituara nga paga e tij dhe e bashkëshortes. Gjithashtu sqaroi se ka kryer udhëtim me shërbim në Sh.B.A. në vitin 2022, me shpenzime nga Ambasada e SH. B.A. në vlerën 2.000 USD, përfshirë fjetje 1. 100 USD (120.000 lekë të derdhura në llogarinë e tij në Raiffeisen Bank, në datë 27.05.2022) dhe ushqim 900 USD (cash të cilat iu dhanë në Sh. B. A). Subjekti sqaroi se biletat e udhëtimit u paguan nga Ambasada e Sh.B.A.
- Subjekti sqaroi se sa i përket udhëtimeve të tij, njëri nga udhëtimet drejt Greqisë, ai nga Aeroporti Rinas, i datave 14.6.2022 - 16.6.2022, i përket një udhëtimi pune ku ka qenë me shërbim dhe se vlerat e deklaruara për shpenzime udhëtimi në Greqi i prkasin 2 daljeve të tjera, konkretisht nga Qafë Bota në vitin 2021 dhe Porti i Sarandës në vitin 2022.
- *Sa më sipër*, subjekti ka dorëzuar ekstrakt nga sistemi TIMS, datë 29.6.2023, për hyrje/daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë së shtetasit Kastriot Skënderaj, ku rezulton se:
 - në pikën kufitare Qafë Botë ka dalë në datën 07.08.2021 dhe ka hyrë në datën 19.08.2021
 - në pikën kufitare Rinas ka dalë në datën 31.05.2022 dhe ka hyrë në datën 06.06.2022;
 - në pikën kufitare Rinas ka dalë në datën 14.06.2022 dhe ka hyrë në datën 16.06.2022;
 - në pikën kufitare Porti i Sarandës ka dalë në datën 05.08.2022 dhe ka hyrë në datën 16.08.2022.
- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, e datës 29.06.2023, për llogarinë e Kastriot Skënderaj, ku në datën 27.05.2022, rezulton se i është kredituar shuma 120.000 lekë me përshkrim "Payment Skënderaj INL. Travel in Washington".
- Subjekti ka bashkëlidhur ekstrakt nga sistemi TIMS, për hyrje/daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë së shtetases Marinela Skënderaj, ku rezulton se:
 - në pikën kufitare Qafë Botë, ka dalë në datën 7.8.2021 dhe ka hyrë në datën 19.8.2021.
 - në pikën kufitare Porti i Sarandës ka dalë në datën 5.8.2022 dhe ka hyrë në datën 16.8.2022.
- Ekstrakt nga sistemi TIMS, për hyrje/daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë së shtetasit L. Skënderaj, ku rezulton se:
 - në pikën kufitare Qafë Botë ka dalë në datën 7.8.2021 dhe ka hyrë në datën 19.8.2021.

- në pikën kufitare Porti i Sarandës ka dalë në datën 5.8.2022 dhe ka hyrë në datën 16.8.2022.
- Ekstrakt nga sistemi TIMS, për hyrje/daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë së shtetasit L. Skënderaj, ku rezultojnë se:
 - në pikën kufitare Qafë Botë ka dalë në datën 7.8.2021 dhe ka hyrë në datën 19.8.2021.
 - në pikën kufitare Porti i Sarandës ka dalë në datën 5.8.2022 dhe ka hyrë në datën 16.8.2022.

Konkluzione:

- ✓ *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar sa i përket hyrje-daljeve nga RSH, gjatë periudhës 2020 - 2022, të subjektit dhe personave të lidhur me të.*
- ✓ *Shpenzimet e deklaruara për udhëtimet private, personale dhe të personave të lidhur gjatë periudhës së sipercituar, rezultojnë në total rreth 3.000 euro, konvertuar rreth 345.000 lekë.*
- ✚ Për arsimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin. llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore si dhe kohëzgjatjen e studimeve, sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit të vlerësimit - Periudha nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agencisë së Mbikëqyrjes Policore deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë.

Subjekti deklaron:

- Shpenzime për arsimin e djalit L. Skënderaj. Arsimi 9 vjeçar në shkollat jopublike: "*****", Tiranë, viti 2015, vlera 300.000 lekë; "*****", Tiranë, vitet 2016 deri aktualisht, vlera 1.200.000 lekë. Shuma 1.500.000 lekë.

✚ Dokumentacioni bashkëlidhur

- Vërtetim nxënësi nr.*** prot., date 17.2.2023 i Shkollës 9-vjeçare Jopublike "*****" për detyrimin sipas viteve akademike të L. Skënderaj, në v. 2016 - 2017 = 1.350 euro, v. 2017 - 2018 = 1.350 euro, v. 2018 - 2019 = 1.350 euro, v. 2019-2020 = 200.000 lekë, v. 2020-2021 = 189.344 leke, v. 2021-2022 = 179.100 lekë, v.2022-2023 = 184.500 lekë. (Shuma e konvertuar = 1.218.734 lekë, kursi i këmbimit në 3.3.2023 = 115.01).

✚ Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

- Subjekti sqaroi se ka kryer pagesën 2.219 euro, për vitin shkollor 2015 - 2016, në Shkollën "*****", sipas vërtetimit të dorëzuar, lëshuar nga Shkolla, dhe pagesat në vlerën 1.200.000 lekë, në Shkollën 9 vjeçare "*****", sipas vërtetimit të dorëzuar. Subjekti sqaroi

se shuma e paguar deri tani në vlerën 1.480.000 lekë, për arsimimin e djalit, është paguar me të ardhurat e përfituara nga paga e tij dhe e bashkëshortes, me këste mujore.

➤ **Sa më sipër**, subjekti ka dorëzuar:

- Vërtetim nr. 1465 prot, datë 3.7.2023 lëshuar nga Kolegji "*****" ku vërtetohet se nxënësi L. Skënderaj ka ndjekur studimet pranë këtij kolegji për vitin akademik 2015 - 2016 dhe se janë shlyer detyrimet për këtë vit shkollor në vlerën 2.219 euro. (Shuma e konvertuar = 255.207 lekë, kursi i këmbimit në 3.3.2023 =115.01).

Konkluzione:

- ✓ *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.*
- ✓ *Shpenzimet e deklaruara për arsimimin e djalit Lukas, gjatë periudhës deri në ditën e plotesimit të formularit të deklarimit të pasurisë sipas dokumentacionit të paraqitur rezultojnë 752.944 lekë + 6.269 Euro, konvertuar në total rreth 1.474.000 lekë.*

DEKLARIMI I BASHKËSHORTES (Marinela Skënderaj)

- Deklarimi i pasurisë

Pasuria Nr. 1

Apartament në pronësi, me sipërfaqe 57.5 m², me nr. Pasurie ****, ind. i hartës: SR:***, ZK ***, me adresë: Rr.***, nd. nr. SH/K *, ap. nr. ***, Bashkia Sarandë. Vlera: 25.000 euro. Pjesa takuese: 50%.

Burimi i krijimit: Llogari rrjedhëse nr. ***** në Bankën Raiffeisen sh.a, në emër të Marinela Skënderaj, me gjendje në 27.6.2022, në shumën 25.000 euro, krijuar nga të ardhura nga:

- Shitblerja e autoveturës me targë AA****, në bashkëpronësi me b/shortin, me kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., date 18.4.2018, në shumën 6.000 euro.
- Shitja e autoveturës me targë AA****, në pronësi time, me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.6.2021, në shumën 4.000 euro.
- Shitblerja e autoveturës me targë AN, në bashkëpronësi me b/shortin, me kontratë shitje nr. *** rep., nr. ** kol., datë 17.1.2022, në shumën 10.000 euro.
- Paga në llogarinë individuale Kastriot Skënderaj, në RFZ Bank, në shumën 600.000 lekë (konvertuar 5.000 euro).

Trajtuar më sipër

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura nga paga përfituar me akte ligjore si rezultat i humbjes së vendit të punës për shkak të transferimit të bashkëshortit si punonjës policie, për periudhën janar 2006 (koha kur ka filluar për herë të parë të trajtohet me pagë) deri në shtator 2009. Shuma 601.122 lekë.
- Të ardhura nga paga përfituar me akte ligjore, si rezultat i humbjes së vendit të punës për shkak të transferimit të bashkëshortit si punonjës policie, për periudhën tetor 2009 deri në 31.12.2013. Shuma 584.486 lekë.
- Të ardhura nga paga si punonjëse në administratën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për periudhën 01.01.2014 deri aktualisht. Shuma 6.940.000 lekë.

Dokumentacioni bashkëlidhur

- Vërtetim nr. ** prot., datë 14.2.2023, i Kuvendit për pozicionet e punës të mbajtura nga Marinela Skënderaj dhe të ardhurat neto nga paga të përfituara prej saj në v. 2014 = 704.504 lekë, v. 2015 = 702.955 lekë, v. 2016 = 702.725 lekë, v. 2017 = 734.297 lekë, v. 2018 = 742.565 lekë, v. 2019 = 745.011 lekë, v. 2020 = 747.455 lekë, v. 2021 = 749.900 lekë, v. 2022 = 928.056 lekë. Shuma e përgjithshme 6.757.468 lekë.
- Vërtetim i Raiffeisen Bank, datë 13.4.2018 me të dhënat vjetore mbi produktet bankare të klientit Marinela Skënderaj, ku evidentohet llogari rrjedhëse në lekë, me nr. ***** me kreditime totale vjetore për periudhën 2009- 2018 dhe llogari rrjedhëse në euro me nr. ***** , me kreditime totale vjetore për periudhën 2009 - 2010.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

- Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 8.5.2023, konfirmon nga nxjerrja e llogarisë së Marinela Skënderaj ka përfituar të ardhura nga paga për periudhën qershor 2006 - shtator 2009, në shumën = 588.832 lekë, të përfituara në llogarinë e Kastriot Skënderaj me përshkrimin "paga Marinela Skënderaj". Gjithashtu konfirmon nga nxjerrjet e llogarisë së Marinela Skënderaj ka përfituar të ardhura nga paga për periudhën shtator 2009 - shkurt 2014, në shumën = 605.798 lekë; për periudhën shkurt 2014 - mars 2023, në shumën = 6.930.750 lekë nga pagat dhe 3.500 lekë dieta. Gjendja e llogarisë nr. *****, në datë 3.3.2023,rezulton në vlerën 81.418 lekë dhe gjendja e llogarisë nr. *****, në datën 3.3.2023, rezulton në vlerën 1 euro.
- Tirana Bank, konfirmon nga nxjerrjet e llogarisë së Marinela Skenderaj ka përfituar të ardhura nga paga për periudhën janar 2011 - prill 2012, në shumën = 254.045 lekë.
- ISSH, me shkresën nr. *****prot., datë 10.5.2023, konfirmon se Marinela Skënderaj ka realizuar të ardhura nga punësimi për periudhën maj 2012 - janar 2014, nga strukturat

në varësi të Policisë së Shtetit, dhe për periudhën janar 2014 - mars 2023 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

- Subjekti sqaroi se diferenca në deklaram për periudhën e parë të të ardhurave (janar 2006 - shtator 2009) është shumë e vogël dhe mund të jetë lapsus në llogaritje. Sa i përket periudhës së dytë të të ardhurave (tetor 2009 - 31.12.2013), diferenca konsiston përfaqësisht në të ardhurat e perfituara pranë Tirana Bank të cilat janë harruar gabimisht pa deklaruar. Gjithashtu subjekti sqaroi se janë harruar gabimisht pa deklaruar shumat e perfituara nga bashkëshortja në Pro Credit Bank, të cilat i përkasin të ardhurave nga punësimi i saj si punonjëse në Fondacionin EDU-PRO, Pogradec, me Administrator A. Sh, në vitet 2004 - 2005, kohë gjatë të cilës subjekti për shkak të detyrës ka jetuar/banuar në qytetin e Pogradecit së bashku me familjen e tij. Subjekti sqaroi se këto shuma nuk ka pasur arsye pse mos t'i deklaronte, duke qenë se janë perfituar me bankë dhe janë të evidentueshme, por ka qenë thjesht harresë e momentit gjatë deklaramit.
- Në lidhje me mosevidentimin e gjendjes së likuiditeteve në llogari bankare, subjekti sqaroi se është keqkuptuar në mënyrën e deklaramit të formularit. Gjithashtu sqaroi se bashkëlidhur formularit ka depozituar dokumentacion në lidhje me llogaritë bankare, ku identifikohen këto llogari në zotërimin e tij dhe të bashkëshortes, e për rrjedhojë e ka konsideruar të ezauruar detyrimin e tij për të identifikuar llogaritë bankare, duke qenë se ka paraqitur edhe dokumente në lidhje me këto llogari, pa patur qëllim mospasqyrimin.

Konstatime:

- Llogaria e pagës së b/shortes në RFZ Bank është deklaruar në deklaramtën e interesave private të vitit 2022.
- Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga dhe dieta, për periudhën qershor 2006 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 7.943.076 lekë.
- Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me mospasqyrimin e gjendjes së mbetur në llogaritë e b/shortes në lekë dhe euro, për të cilat b/lidhur deklaramtës së pasurisë ka paraqitur vërtetim bankar për numrin e llogarisë.
- RFZ Bank konfirmon gjendjet në dt. 3.3.2023, në shumën 81.418 lekë dhe në shumën 1 euro.

Konkluzione:

Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaramta dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaramta, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesave, u bë analiza e të

dhënave të deklaruara nga subjekti me informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, proces nga i cili, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se:

- Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, pasuria totale deri në datë 03. 03. 2023, është deklaruar bruto/neto 5.469.898 lekë + 28.001 Euro, e konvertuar rreth 9. 157. 500 lekë.
- Të ardhurat e Kastriot Skënderaj nga pagat, shpërblimet, honoraret, dietat, pagesat për udhëtim dhe për veshje, për periudhën korrik 1989 - mars 2023, rezultojnë në vlerën totale rreth 23. 125. 672 lekë.
- Të ardhurat e Marinela Skënderaj nga pagat dhe dietat, për periudhën Qershor 2006– mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 7.943.076 lekë.

Gjithashtu, është përdorur si burim:

- Të ardhura neto nga shitja e apartamentit të shoqërisë "Haëai-ALB" shpk, ne v. 2006 në shumën e konvertuar rreth 4.031.000 lekë (Blerë në v. 2002 në shumën 18.000USD / shitur në v. 2006, në shumën 52.000 euro).
 - Kredi e marrë në RFZ Bank për mobilim apartmenti në Selitë v. 2008, në shumën 1.000.000 lekë (e shlyer).
 - Kredi e marrë në RFZ Bank v. 2013, në shumën 600.000 lekë (e shlyer).
 - Për periudhën 2000 - 2023, referuar treguesve statistikore të INSTAT, janë shpenzuar minimalisht për konsum familjar, rreth 13.259.412 lekë.
 - Për periudhën 1.1.2022 - 31.12.2022, janë shpenzuar për ujë, drita, telefon dhe internet etj., në total rreth 152.000 lekë.
 - Për periudhën 1.1.2020 - 31.12.2022, janë shpenzuar për udhëtime personale dhe të personave të lidhur në total rreth 3.000 euro, e konvertuar rreth 345.000 lekë.
 - Për periudhën deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, janë shpenzuar për arsimin e djalit, L. Skënderaj, në total rreth 752.944 lekë dhe 6.269 euro, e konvertuar rreth 1.459.294 lekë.
 - Për periudhën deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, janë shpenzuar për punime të brendshme dhe arredim banese, në total rreth 2.400.000 lekë.
- ✓ *Në konkluzion për vlerësimin e pasurisë, në përputhje me pikën 6 të nenit 34 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, trupa vlerësuese, arrin në përfundimin se:*
- a) *deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe se punonjësi nuk gjendet në situatë konflikti interes;*

b) nuk ka mundësi të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;

c) nuk është kryer fshehje e pasurisë;

ç) nuk është kryer deklarim i rremë;

d) punonjësi nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit

Tabela nr.1: Analiza Financiare e subjektit Kastriot Tajar Skënderaj dhe personave të tij të lidhur

| Burimi/Viti | 1989-1993 | 1993-1997 | 1998 | 2001 | 2002-2004 | 2005 | 2006-2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016-2018 | 2019 | 2020-2021 | 2022-2023 | TOTALI |
|---|-----------|-----------|---------|---------|-----------|-----------|------------|-----------|-----------|-----------|-----------|------------|------------|------------|-----------|------------|
| Të ardhura neto nga paga apo shperblime nga marredheniet e punesimit | 31,575 | 179,000 | 135,889 | 802,193 | 1,192,658 | 1,050,052 | 5,916,661 | 1,065,225 | 941,034 | 998,403 | 1,373,386 | 3,892,128 | 1,261,813 | 2,738,019 | 1,547,636 | 23,125,672 |
| Të ardhura neto nga paga apo shperblime nga marredheniet e punesimit (bashkëshortja M. Skënderaj) | | | | | | | 601,122 | | 584,486 | 704,504 | 702,955 | 2,179,587 | 745,011 | 1,497,355 | 928,056 | 7,943,076 |
| Te ardhura te krijuara nga shitja e pasurive te huajshme dhe te paluajshme | | | | | | | 5,436,600 | | | | | | | | | 5,436,600 |
| Totali i të Ardhurave dhe te hyrat | 31,575 | 179,000 | 135,889 | 802,193 | 1,192,658 | 1,050,052 | 11,954,383 | 1,065,225 | 1,525,520 | 1,702,907 | 2,076,341 | 6,071,715 | 2,006,824 | 4,235,374 | 2,475,692 | 36,505,348 |
| Detyrime: Te hyra nga huate/kredi | | | | | | | 1,000,000 | | 600,000 | | | | | | | 1,600,000 |
| Shpenzime jetike sipas INSTAT | | | | 468,060 | 1,029,732 | 332,136 | 2,245,632 | 279,096 | 418,644 | 860,568 | 822,552 | 2,768,508 | 995,868 | 2,000,856 | 1,037,760 | 13,259,412 |
| Shpenzime për Arsimin | | | | | | | | 96,000 | 96,000 | | | 349,650 | 164,700 | 389,344 | 363,600 | 1,459,294 |
| Shpenzime Udhëtimi jashte vendit | | | | | | | | | | | | | | 345,000 | | 345,000 |
| Shpenzime Kredie Bankare Leasing, etj | | | | | | | 1,000,000 | | 600,000 | | | | | | | 1,600,000 |
| Shpenzime dhe te dala te tjera. | | | | | 600,000 | | 800,000 | | | | | | 1,332,500 | | 252,000 | 2,984,500 |
| Totali i shpenzimeve dhe te dalave | - | - | - | 468,060 | 1,629,732 | 332,136 | 4,045,632 | 375,096 | 1,114,644 | 860,568 | 822,552 | 3,118,158 | 2,493,068 | 2,735,200 | 1,653,360 | 19,648,206 |
| Investime pasuri | | | | | 2,484,000 | 400,000 | 4,530,000 | 500,000 | | | 1,011,000 | | 1,490,000 | 400,000 | 2,872,500 | 9,157,500 |
| Gjendje Cash (ndryshimi: shitim /pakesim) | | | | | | | | | | | | | | | | - |
| Totali Pasuri | - | - | - | - | 2,484,000 | 400,000 | - | 500,000 | - | - | 1,011,000 | - | 1,490,000 | 400,000 | 2,872,500 | 9,157,500 |
| Mundesia per Kursime : Te Ardhura+Detyrime-Shpenzime-Pasuri. | 31,575 | 210,575 | 346,464 | 680,597 | 2,240,477 | 1,922,561 | 6,986,190 | 7,176,319 | 8,187,195 | 9,029,534 | 9,272,323 | 12,225,880 | 10,249,636 | 11,349,810 | 9,299,642 | |

B. KONTROLLI I FIGURËS

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre elementë:

1. të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
2. raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
3. verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, gërma (ë), e ligjit 12/2018, i ndryshuar.

✚ **TRUPA E VLERËSIMIT**, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të vlerësimit Z. Kastriot Skënderaj, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikimit nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.

✚ **Për kontrollin e figurës, TRUPA E VLERËSIMIT administroi:**

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”.
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
- c. Korrespondencën me institucionet ligjzbatuese.

Në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse, rezulton se:

- Nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve të subjektit të vlerësimit.
- Subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk rezultojnë të dënuar.
- **Nuk ka** të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtëpërdrejtë ose indirect në veprime të dyshimta.
- **Nuk ka** të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”), ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj.
- **Nuk ka** të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (persona të dënuar apo proceduar penalisht, Brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10 192 datë 30.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar).
- **Nuk ka** të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale.
- **Nuk ka** të dhëna nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale.
- **Nuk ka** të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhëri ndërkombëtar, për kryerje e një vepre penale.
- **Nuk ka** të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj.

- **Nuk ka** të dhëna për përfshirje në aktivitet të kundërligjshëm
- **Nuk ka** procedime penale të referuara
- Për subjektin e vlerësimit **nuk disponohen** ankesa, të dhëna ose informacione që lidhen me objektin e kërkesës.
- **Nuk është** nxjerë urdhër ndalimi
- **Nuk është** kërkuar masë e sigurimit personal
- **Nuk është** marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit në hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale
- **Nuk ka pasur** regjistrim të njoftimit të veprave penale
- **Nuk ka pasur** raste të urdhrave ndërkombëtare të ndalimit.
- **Nuk rezulton** të jetë regjistruar ndonjë procedim penal për subjektin apo personat e lidhur me të.
- Subjekti është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”, me datë lëshimi 19.11.2021, të vlefshme deri më datë 18.11.2026. për subjektin e vlerësimit nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP-së.
- nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera.
- Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
- Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.
- Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri më 2 Korrik 1991.

Testi për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se subjekti vlerësimit **Z. Kastriot Skënderaj**,

Në përfundim të testit, sipas ekzaminimit toksikologjiko-ligjor nr. *** të ardhur nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, me shkresë nr. **** prot., datë 05.12.2023, jemi bërë me dije se:

“Në mostrën e marrë subjektit nuk u zbulua prania e produkteve të lëndëve narkotike të grupit të MOP (opiate/heroinë), COC (cocaine), MTD (metadon), THC (canabinoide/cannabis sativa), BARB (barbiturate), TCA (trciklike antidepressante), AMP (amphetamine), MDMA (ekstazi), LSD (acid lisergjik), BZO (benzodiazepinë).”

✓ *Në konkluzion për vlerësimin e figurës, në përputhje me pikën 3 të nenit 42 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, trupa vlerësuese, arrin në përfundimin se:*

a) punonjësi nuk ka kryer deklaram të rremë;

b) nuk ka informacione, të dhëna të vërtetuara nga agjencitë ligjzbatuese që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar;

c) nuk ka informacion në deklarin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj, që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
- raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standartet profesionale në Policinë e Shtetit/Gardën e Republikës/Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit 12/2018, i ndryshuar.

Subjekti i vlerësimit **Z. Kastriot Skënderaj**, në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin Drejtor në Drejtorinë Vendore të Policisë Berat, funksion të cilin e ushtron aktualisht sipas Urdhërit Nr. 2559/1, datë 22.11.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet, sipas përcaktimeve të nenit 44 pika 2 dhe 3 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.

Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në:

- Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit .
- Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, sistemi RMIS.
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të Nenit 44, pika 1, Ligjit Nr. 12/2018 , i ndryshuar, të mbështetur në dokumentacionin shoqërues.
- Të dhënat e siguruar nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi Performancën e subjektit.

Nga shqyrtimi dhe analizimi i të burimeve të mësipërme, konstatohet si më poshtë vijon:

- **TË DHËNA MBI ARSIMIMIN**

Sipas të dhënave të administruara, rezulton se subjekti:

- Ka përfunduar arsimin e lartë në shkollën e Lartë të Ministrisë së Brendshme, në periudhën 1985-1989, diplomuar më 28.06.1989 në degën “Policë”.

Sa më sipër, subjekti përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që kryen, sipas përcaktimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

• **TRAJNIMET DHE KUALIFIKIMET**

Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit, rezulton se ka kryer trajnimet dhe specializimet përkatëse sipas funksioneve të ushtruara ndër vite për periudhën 1999-2022.

Gjithashtu, gjatë karrierës rezulton se subjekti ka marrë Certifikatë për performancë të lartë në realizimin e detyrave e konkretisht:

- Viti 2017 dhe Viti 2022

VLERËSIMET E PUNËS

Në dosjen personale të subjektit të vlerësimit, për periudhën 2018-2023, rezulton se janë të administruara 3 (tre) vlerësime të aftësive individuale të punës në të cilat është vlerësuar si vijon:

- **Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2019 28 pikë (shumë mirë)**
- **Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020 28 pikë (shumë mirë)**
- **Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021 28 pikë (shumë mirë)**

Në vlerësimet e mësipërme vlen të theksojmë se në periudhën 2018-2021, vlerësimi maksimal i punonjësve sipas formularit të vlerësimit ishte 28 pikë, ndërkohë nga viti 2022 e në vazhdim vlerësimi maksimal është 100 pikë.

Vlerësimi i aftësive individuale të punës sipas standardeve të përcaktuara bëhet nga eprori i drejtëpërdrejtë, bazuar në vlerësimin e integritetit, profesionalizmit, komunikimit, qëndrimin konstruktiv, paanshmërisë, punës në grup si dhe planifikimi dhe organizimit të punës.

Bazuar në sa vlerësimet e mësipërme të administruara në dosjen personale të punonjësit, konkludohet se subjekti ka përmbushur detyrat profesionale, ka respektuar rregullat e etikës si edhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.

MASAT DISIPLINORE

Nga verifikimi i dosjes personale dhe sistemit RMIS, nuk rezulton të ketë masë administrative në fuqi sipas legjislacionit përkatës.

ECURIA NË KARRIERË

Subjekti Kastriot Skënderaj, ka një karrierë në Policinë e Shtetit prej 34 vitesh. Nga verifikimi rezulton se gjatë periudhës 5 vjeçare objekt deklarimi, subjekti Kastriot Skënderaj ka ecurinë si më poshtë vijon:

- 23.11.2022- Aktualisht mban detyrën Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Berat.

- 01.07.2021-22.11.2022 ka ushtruar detyrën Drejtor Kabineti i Drejtorit të Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- 12.03.2019-30.06.2021 ka ushtruar detyrën si Këshilltar në Kabinetin e Drejtorit të Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- 16.02.2018-11.03.2018 ka ushtruar detyrën Drejtor në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë.
- 08.06.2017-15.02.2018, ka ushtruar detyrën Drejtor i Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Tiranë.

Subjekti i Vlerësimit, Z. Kastriot Skënderaj, aktualisht mban gradën Drejtues i Parë sipas Urdhërit Nr. 338 datë 15.02.2018.

✓ *Në konkluzion për vlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me pikën 1 të nenit 47 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, trupa vlerësuese, arrin në përfundimin se:*

a) është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;

b) ka vlerësime pozitive pune;

c) ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban.

V. KONKLUSIONI PËRFUNDIMTAR

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i vlerësimit z. Kastriot Skënderaj, në përputhje me nenin 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë,
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës,
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE

Trupa e Vlerësimit, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në bazë të germës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit **Kastriot Tajar Skënderaj**, me funksion Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Berat.

2. Vendimi i arsyetuar me shkrim, u njoftohet Subjektit të Vlerësimit si edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së Vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikqyrjes Policore, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall sot datë 07.03.2024, në Tiranë.

TRUPA E VLERËSIMIT

Loreta HANXHARI

Kryesuese

Bora VRENJO

Relatore

Henri NAQELLARI

Anëtar